

*Gjyrate*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E PRIVATIZIMEVE**  
**DREJTORIA E TRANSFORMIMIT DHE PRIVATIZIMIT**

Nr. 1021.Prot.

Tirane, me 15.071997.

**U R D H E R**

I

**AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIJME**  
**"ALIMPEKS" TIRANE**

Nr. 1241 date \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .1997.

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime "Alimpeks" Tiranë, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 1 te Dekretit 1631, date 1.11.1996, miratuar me Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, "Per miratimin me ndryshime te dekretit Nr.1631, date 1.11.1996, Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.4.1995 "Per trasnfromimin e ndermarrjeve ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195 date 14.8.1995 dhe Ligjin Nr.8099, date 28.3.1996", dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".


***Urdheroj:***

1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime "Alimpeks" Tiranë, te behen ndryshimet e meposhtme :

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te zbritet vlere prej 101 919 000 lekë, e cila përbën dëmin material të kësaj shoqërie si pasojë e vjedhjeve dhe shkatërrimeve të ndodhura në magazinat e saj në Durrës, si dhe numri i aksioneve 101 919. Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Ngarkohet Drejtoria e Transformimit dhe Privatizimit te beje veprimet perkatese per zvogelimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtare dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".

**MINISTRI**  
**EDUARD YPI**



AKT - EKSPERTIZE

KONTABELE

PER NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERIS ANONIME ALIMPEKS  
TIRANE

PER DEMET E SHKAKTUARA NE NGJARJET E FUNDIT.

Une i nenshkruari Kosta Qerama i autorizuar me detyren e ekspertit kontabel, verifikova veprimet kontabele per demet e shkaktuara Shoqeris Anonime Alimpeks Tirane , si rezultat i demeve te ndodhura ne ngjarjet e jashtezakonshme te koheve te fundit.

Nga kontrolli i bere rezalton se ndermarja ka kryer inventaret fizike te mallrave e materialeve qe kishin pesuar deme , me komision te rregullt dhe mbi bazen e kesaj jane mbajtur procesverbalet perkatese.

Nga krahasimi i te dhenave kontabele me gjendjen fizike me daten 20.3.1997, rezultojne diferenca te cilat Shoqeria Anonime i ka kontabilizuar ne llogarite perkatese ne perputhje me planin kontabele.

Sipas bilancit kapitali themeltar me 31.12.96 rezulton ne 209.950.000 leke, ndersa demet e shkaktuara kapin vleren prej 101.919.000 leke.

Perfundimisht kapitali themeltar me daten 20.3.97 mbetet leke 108.031.000 nga 209.950.000 qe ishte, i cili del:

- Kapitali themeltar sipas bilancit 31.12.1996 leke 209.950.000
- Ndryshimi ose pakesimi nga demet e pesuara sipas inventarit me 20.3.1997..... " 101.919.000
- Kapitali themeltar qe mbetet ..... leke 108.031.000  
( Njiqindetete milione e tridhjet enji mije leke)

EKSPERTI KONTABELE

Tirane me 15.5.1997

Kosta Qerama

